

Anton Bardhaj, MA<sup>1</sup>

UDC:  
347.932: 341.231.14(4)

**E DREJTA PËR T’U GJYKUAR BRENDË NJË AFATI TË ARSYESHËM  
KOHOR DHE STANDARDET E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË  
DREJTAT E NJERIUT – DILEMAT DHE SFIDAT**

**ПРАВОТО НА СУДЕЊЕ ВО РАЗУМЕН ВРЕМЕНСКИ РОК И  
СТАНДАРДИТЕ НА ЕВРОПСКИОТ СУД ЗА ПРАВАТА НА  
ЧОВЕКОТ – ДИЛЕМИ И ПРЕДИЗВИЦИ**

**RIGHT TO TRIAL WITHIN A REASONABLE TIME PERIOD AND  
STANDARDS OF EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS –  
DILEMMAS AND CHALLENGES**

**Abstract**

The notion “Trial within a reasonable time” guaranteed by the provision of Article 6 paragraph 1 of the European Convention on Human Rights cannot be determined precisely. Also, this notion is not formulated even by the European Court of Human Rights in Strasbourg. In this regard, there is a general opinion that the notion “Trial within a reasonable time” is defined in the ECTHR case law. Therefore, this paper aims to analyze the theoretical and practical aspects of the trial within a reasonable time, whereby the author will also recommend appropriate measures to improve the efficiency of the judiciary, addressing the problem of completing court proceedings within a reasonable time frame that faces a considerable number of states, including the

---

<sup>1</sup> Autori është Magjistër i shkencave juridike si dhe Kandidat i Doktoraturës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës në Programin studimor: “Historia e institucioneve dhe shteti i së drejtës” në drejtimin: “Marrëdhënie ndërkombëtare dhe historia e diplomacisë”. E-mail Adresa: bardhajanton@gmail.com.

countries of the South East Europe region, as there is a broad conviction that court proceedings in these states last a long time, so the citizens of these countries have the right to appeal through the petitions to the European Court of Human Rights for violation of the right to trial within a reasonable time, guaranteed by the provision of Article 6 paragraph 1 of the ECHR. Finally, this paper will also elaborate on the problems of court activity in relation to the time element, in order to analyze the legal form that has a reasonable time frame, bringing case studies from the judicial practice of the courts of state region, in a comparative view to European standards of ECHR. Comparison of court cases will reveal whether there is a lack of consistency between these judicial institutions in solving practical cases.

**Key words:** Trial in a reasonable time; European Court of Human Rights; European Convention on Human Rights; Court practice; Efficiency in justice.

## 1. Hyrje

Punimi ka si qëllim të studimit të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Për të pasur një tablo të qartë mbi të drejtën për një proces të rregullt ligjor, do të pasqyrohen dispozitat e Kushtetutës dhe KEDNJ, aksesin në drejtësi dhe afatin e arsyeshëm kohor sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ. Nxjerrja në pah dhe analiza e faktorëve përcaktues të aksesit në drejtësi dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor na lejon të kuptojmë më mirë problematikat që çojnë në mosrespektim të këtyre të drejtave si dhe cilat janë masat që duhet të merren për shmangien e cenimeve të tyre. Procesi i rregullt ligjor është më i prekshëm kur një individ është pjesë e një procesi gjyqësor në të cilin nuk është respektuar detyrimi që buron nga neni 6 i Konventës. Si rrjedhim, neni 6 të Konventës nuk mund t'i bëhet një interpretim i ngushtë pasi në disa raste kjo do të sillte shmangie nga kuptimi i dhënë nga kjo Konventë kësaj të drejte. Studimi i afatit të arsyeshëm kohor, nuk qëndron vetëm në mekanizmat mbrojtës të vendosura në Strasburg për të hetuar shkeljet e kallëzuar dhe për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga Konventa, por dhe në trajtesën doktrinare që u bëhet atyre.

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm parashihet si objekt trajtimi në një mori instrumentesh ndërkombëtare dhe paraqitet si një nga të drejtat themelore për të pandehurin në procedurë penale. Gjykatat dhe sistemi gjyqësor në përgjithësi, duhet të ruajnë integritetin

e vet institucional, duke vepruar me shpejtësi në emër të drejtësisë dhe duke i trajtuar çështjet që ngrihen pranë tyre me profesionalizëm, duke i zgjidhur ato brenda afateve optimale kohore. Gjykatat nuk duhet të kenë si objektiv vetëm funksionimin e tyre si qëllim të vetëm, ato duhet t'i kushtojnë rëndësi të posaçme besueshmërisë që publiku duhet të ketë në institucionet e drejtësisë, si një nga detyrat e rëndësishme të tyre. Trajtimi i çështjeve brenda afateve kohore të arsyeshme, e ruan dhe e ngrit besueshmërinë dhe kredibilitetin e institucioneve të drejtësisë përballë publikut.

Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, i vë kufizime restriktive bartësve të sistemit të drejtësisë, duke kërkuar prej tyre efikasitet në udhëheqjen dhe përfundimin e çështjeve penale. Lënia e çështjeve në mëshirën e organeve të drejtësisë, pa i vendosur dhe kërkuar afate strikte për përfundimin e tyre, mund të shndërrojë procedurën penale në një procedurë arbitrare, gjë që shkakton shkeljen dhe mohimin e të drejtat themelore të të pandehurit. Drejtësia duhet të vijë brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe nuk duhet zgjatur pafundësisht që të shndërrohet në procedurë penale abuzuese dhe të shpërdoruar përballë autorizimeve dhe kompetencës së dhënë ligjore. Pushteti gjyqësor është pushtet i pavarur shtetëror dhe i njëjti nuk i nënshtrohet asnjë pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, e as nuk mund të vihet në dilemë kredibiliteti i punës së tij. Pavarësia e pushtetit gjyqësor është e garantuar me Kushtetutë të secilit shtet dhe nuk mund të kontestohet nga pushtetet e tjera shtetërore. Përfundimi i çështjeve brenda afatit të arsyeshëm u jep të gjithëve siguri juridike si dhe largon nga stigma të cilën e përcjellë gjatë kësaj periudhe. Drejtësia e cila vendoset brenda afatit kohor të arsyeshëm ndihmon në vendosjen e drejtë të çështjes penale, pasi zgjatja e paarsyeshme krijon çdoherë mundësi për të dyshuar për rregullsinë e procesit, pasi dëshmitarëve mund t'u zbehet kujtesa, mund të mos jenë të gatshëm të dëshmojnë, apo në rastin më të keq, nuk janë fizikisht të qasshëm nga autoritetet shtetërore.

## **2. Kuptimi i së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm kohor**

Tradicionalisht e drejta për gjykim brenda “*afatit të arsyeshëm*” ose e drejta në “*gjykim të shpejtë*”, siç quhet ndryshe, shihet si garanci për mbrojtjen e palëve. Kërkesa për gjykim brenda afatit të arsyeshëm garanton se brenda një afati të arsyeshëm me anë të vendimit gjyqësor do të përfundojë pasiguria e subjekteve të së drejtës. Kjo kërkesë shtrohet në

interes të dyfishtë, të personave me të cilët ka të bëjë drejtpërdrejtë, si dhe në interes të sigurisë së përgjithshme juridike. Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm nuk është kategori fikse e përcaktuar në mënyrë strikte, por është fjala për një standard të cilin gjykata e vlerëson në mënyrë të veçantë për çdo rast konkret. Koha e cila llogaritet si afat i arsyeshëm fillon të rrjedhë nga momenti i inicimit të procedurës përkatëse, e deri në momentin e përfundimit të saj në instancën më të lartë të mundshme<sup>2</sup>.

Pra, e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nënkupton se janë marrë disa masa për qëllim zvogëlimin e kohëzgjatjes së procedurave. Nuk nevojitet vetëm parimi se: “*drejtësia e vonuar, është drejtësi e mohuar*”, por duhet gjithashtu të shmanget një situatë ku: “*drejtësia e nxituar, është drejtësi e groposur*”. Me fjalë të tjera, e nevojshme për procedurat gjyqësore është të ekzistojë një ekuilibër midis “efikasitetit” dhe “cilësisë”. Qëllimi kryesor i këtij sistemi është t’u sigurojë gjykatave instrumentet e duhura për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e tyre të shërbimeve<sup>3</sup>. Zhvillimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor është trajtuar si një element thelbësor për një proces të rregullt ligjor. Ky kusht bëhet shumë i ndjeshëm sidomos në çështjet penale. Afati kohor ndryshon nga fakti nëse kemi të bëjmë me një çështje civile apo penale. Këtu merret parasysh kompleksiteti i çështjes, interesi i palëve etj<sup>4</sup>.

E drejta për gjykim brenda “kohës së arsyeshme” është një e drejtë e personit apo më shumë një detyrim për shtetin? Opinioni i shumicës është se kjo e drejtë nuk është një e drejtë e natyrshme, sepse të drejtat e natyrshme kanë një strukturë absolute, që do të thotë se ato duhet të respektohen nga të gjithë, të gjithë duhet të mos i cenojnë ato. Ndërsa kërkesa për të përfunduar gjykimin brenda një afati të arsyeshëm imponon detyrime mbi gjykatat dhe palët, dhe të drejtën për të vepruar e kanë vetëm palët pjesëmarrëse në procedurë. Shteti është i detyruar të marrë çdo masë të nevojshme për të siguruar procese brenda një kohe të arsyeshme, nëpërmjet legjislacionit të duhur dhe mbajtjes së një sistemi efektiv gjyqësor<sup>5</sup>.

<sup>2</sup> Zendeli, E., “E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm”, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, 2009, fq. 3.

<sup>3</sup> Albers, P., “The experiences of the Netherlands” kumtesë në tryezën e rumbullakët të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës me titull “The right to trial within a reasonable time and short-term reform of the European Court of Human Rights”, 2009, fq. 6.

<sup>4</sup> Omari, L; Anastasi, A., “E drejta Kushtetuese” Tiranë, 2008, fq. 159.

<sup>5</sup> Zsuzsanna Lócsey-Illés, Eszter Tamási, Áron László Tóth “How to execute the “reasonable time” decisions of the ECHR—Reactions of the Hungarian legislation”, fq. 16.

Proceset gjyqësore duhet të fillojnë në orarin e caktuar, të vendosur edhe në listën e gjykimeve, listë e cila afishohet në ndërtesën e gjykatës me përjashtim të rasteve kur ka një arsye të justifikuar. Fatkeqësisht, mungon një përcaktim i termit “*arsye e justifikuar*”. Edhe pse vonesa në një proces shpesh mund të jetë e pranueshme, ajo shfaq probleme kur mund të klasifikohet si “e panevojshme”. Për të bërë dallimin midis vonesës së “nevojshme” nga ajo “e panevojshme” nuk është e lehtë. “Vonesa të panevojshme” kemi kur ka kaluar shumë kohë midis paraqitjes së një veprimi dhe vendimit përfundimtar në gjykatë. Ky përkufizim është, natyrisht, jo shumë i saktë, edhe pse vonesat e shkaktuara nga parregullsitë procedurale definitivisht mund të vihen nën këtë përkufizim<sup>6</sup>.

Faktorët që mund të sjellin vonesa të panevojshme janë dyllojësh, procedural dhe joprocedural. Te faktorët proceduralë përmendim nevojën për një shpërndarje të pushtetit midis gjyqtarit dhe palëve; përdorimi i procedurave gojore etj. Ndërsa faktorët joproceduralë janë të lidhur ose jo me gjykatat, stafin, organizimin gjyqësor, legjislacionin e paqartë, etj. Një shembull është një cilësi e dobët e gjyqtarëve, stafit gjyqësor dhe mënyra se si ata shpërblehen mund të jenë një burim potencial i vonesës<sup>7</sup>.

Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ, ka përcaktuar metoda për të llogaritur kohëzgjatjen e procedurave. Për fillimin, pika e llogaritjes është e ndryshme në rastet civile, penale dhe administrative. Në çështjet civile është normalisht data në të cilën çështja është referuar në gjykatë; në rastet penale, dita e fillimit mundet gjithashtu të jetë data në të cilën i dyshuari është arrestuar apo i akuzuar, ose në të cilën kanë nisur hetimet paraprake. Në çështjet administrative, pika e llogaritjes është data në të cilën aplikanti i parë e referon çështjen tek autoritetet administrative. Fundi i periudhës së vlerësuar nga gjykata është: në rastet penale, data në të cilën është dhënë vendimi përfundimtar mbi dosjen materiale, ose vendimi nga prokuroria apo gjykata për të pushuar çështjen. Në çështjet civile, afati korrespondon me datën në të cilën vendim merr formën e prerë<sup>8</sup>.

---

<sup>6</sup> C.H. van Rhee., “In within a Reasonable Time: The History of due and undue delay in Civil Litigation”, fq. 3.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> European Commission For the Efficiency Of Justice (Cepej) Length of court proceedings in the member states of the Council of Europe based on the case law of the European Court of Human Rights(31 July 2011) 2nd Edition,fq4.

Në rastin e vlerësimit të momentit të fillimit të afatit të arsyeshëm kohor, në çështjen *Scopelliti kundër Italisë*<sup>9</sup>, znj. Scopelliti më 6 prill 1989, paraqiti përpara GJEDNJ ankesën e saj për tejzgjatje të gjykimit civil përpara gjykatës së Catanzaros. Në fakt, gjykimi civil në shtetin italian kishte si objekt kundërshtimin e Znj. Scopelliti ndaj dhënies për shfrytëzim pa autorizim të 1000 m<sup>2</sup> që kishte bërë Ministria e Punëve Publike. GJEDNJ u shpreh se perioda që do të merrej në konsideratë, për të vlerësuar nëse ka pasur tejkalim të afateve, fillon më 19 dhjetor 1980 e deri më 1 mars 1989, ku vendimi i gjykatës mori formë të prerë. Nga shqyrtimi i fakteve, Gjykata vendosi se ka shkelje të nenit 6 të Konventës, pasi gjykimi kishte zgjatur nëntë vjet e tre muaj. Kohëzgjatja e procedimeve duhet të llogaritet që nga data në të cilën një shtet kontraktues ka njohur të drejtën për ankimim individual.

Ndonëse GJEDNJ nuk përcakton limite kohore specifike dhe merr në konsideratë rrethanat e çdo çështjeje për të vlerësuar vonesat, një studim i vitit 2006 ka treguar se një kohëzgjatje deri në dy vjet e një çështjeje jokomplekse, zakonisht konsiderohet nga Gjykata si e arsyeshme. Sa u përket çështjeve komplekse, studimi i përmendur më sipër vuri në dukje se për çështjet që kishin zgjatur më shumë se 8 vjet kishte shkelje, ndërkohë që çështjet që kanë zgjatur më shumë se pesë vjet rrallë kanë marrë miratimin e Gjykatës. Sa i përket “*çështjeve me përparësi*”, ku bëjnë pjesë edhe ato të lidhura me gjendjen shëndetësore, kujdestarinë e fëmijëve dhe punësimin, gjykata ka gjetur shkelje edhe kur këto çështje kanë qenë komplekse dhe kanë zgjatur vetëm dy vjet e shtatë muaj. Supozohet që çështjet që kanë përparësi, jokomplekse, të kenë afate edhe më të ngurta<sup>10</sup>.

### **3. Kërkesat e përgjithshme të procesit penal dhe atij civil në lidhje me afatin e arsyeshëm kohor**

Kërkesat e përgjithshme të procesit penal dhe atij civil në lidhje me afatin e arsyeshëm kohor janë pothuajse të njëjta. Afati i arsyeshëm trajtohet nga GJEDNJ si e zbatueshëm për të dyja procedimet, penale dhe civile, edhe pse është vetëm kjo Gjykatë që i referohet në mënyrë eksplicite këtij parimi për të dyja procedimet. Megjithatë duhet të

<sup>9</sup> Scopelliti kundër Italisë, gjykim i datës 23 nëntor 1993, GJEDNJ.

<sup>10</sup> OSCE, “Drejt drejtësisë: Analizë e çështjeve civile në gjykatat e rretheve gjyqësore”, 2013, fq 27.

saktësojmë se afati i arsyeshëm kohor nuk përfshin vetëm proceset gjyqësore, por edhe proceset ankimore ndaj institucioneve shtetërore<sup>11</sup>.

Në çështjet penale, personat e privuar nga liria kanë të drejtë të kenë procedurë gjyqësore me të cilën do të vendoset shpejt ligjshmëria e ndalimit të tyre dhe të urdhërohet lirimi i tyre nëse paraburgimi nuk është i ligjshëm. Personave të arrestuar ose të paraburgosur në lidhje me kryerjen e një veprë penale, duhet t'u sigurohet menjëherë dërgimi përpara një gjykatësi dhe ata kanë të drejtë të marrin një gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohen në pritje të gjykimit. Hetimi duhet të fillojë me shpejtësi në mënyrë që të merret sasia dhe cilësia më e madhe e mundshme e provave, ndërsa kur ka pengesa apo vështirësi që pengojnë përparimin në një hetim në një situatë të veçantë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet mund të konsiderohet si thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut në mirëmbajtjen e sundimin e ligjit. Hetimi duhet të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme dhe në të gjitha rastet të bëhet me gjithë kujdesin e nevojshëm<sup>12</sup>.

Në çështjen *Wemhoff kundër Gjermanisë*, Gjykata është e mendimit se qëllimi i saktë i kësaj dispozite në çështjet penale, është të sigurojë që personat e akuzuar nuk duhet të qëndrojnë nën akuzë për një kohë të gjatë dhe se akuza është e vendosur. Prandaj, nuk ka dyshim që periudha që do të merret parasysh në zbatimin e kësaj dispozite, zgjat të paktën deri në marrjen e vendimit në apel. Nuk ka asnjë arsye pse mbrojtja e dhënë ndaj personave kundër vonesave të gjykatës, duhet të përfundojë në seancën e parë të gjykimit. Shtyrjet e pajustificuara apo vonesat e tepruara nga ana e gjykatave duhet gjithashtu të merren parasysh. Në të gjitha procedimet është e nevojshme që gjyqtarët t'i planifikojnë veprimtaritë e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme. Rregullat e procedurës civile, ndryshe nga procedura penale, nuk përcaktojnë afate maksimale kohore ndërmjet seancave. Nga ana tjetër, në vazhdimësi gjykatat janë orientuar lidhur me afatet kohore procedurale për disa lloje çështjesh. Këto afate kohore përdoren kur vlerësohet puna e gjyqtarëve. Afatet kohore fillojnë që nga regjistrimi i çështjes në gjykatë<sup>13</sup>.

<sup>11</sup> KE., "The Right to a Fair Trial" Collection Science and technique of democracy, No. 28, fq. 80.

<sup>12</sup> KE., "Eradicating Impunity for Serious Human Rights Violations", 2011, fq. 10-12.

<sup>13</sup> Botim i OSBE, "Drejt drejtësisë: Analizë e çështjeve civile në gjykatat e rretheve gjyqësore", 2013, fq. 31

Nga ana tjetër, vonesat në shqyrtimin e çështjeve civile dhe zvarritjet e çështjeve gjyqësore shkaktojnë një sërë problemesh për palët. Me kalimin e kohës, të drejtat ligjore mund të komprometohen në mënyrë të pandreqshme (për shembull, kur pala paditëse falimenton përpara se të ekzekutohen pretendimet e saj ose kur gjendja e sendit si objekt gjykimi mund të përkeqësohet), provat mund të zhduken dhe vërtetimi i fakteve mund të vështirësohet. Gjykimet e shtrira shumë gjatë në kohë, i lënë palët në pasiguri për periudha të gjata kohore dhe mund të shkaktojnë edhe rritje të kostove procedurale. Procedurat gjyqësore duhet të jenë të arsyeshme, të shkurtra, me qëllim që të sigurojnë efektivitetin e të drejtave ligjore të palëve. Ashtu siç u përkrahur edhe më sipër, shpejtësia e gjykimeve duhet balancuar me kujdes me kërkesën po aq të rëndësishme për procedura të sakta dhe të drejta gjyqësore, duke përfshirë këtu edhe nevojën e palëve për të pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur çështjen.

Në raport me shkaqet, për të gjitha procedurat, përpara fillimit të procedurave, shkak i vonesave lidhet me shpërndarjen territoriale të gjykatave; transferimin e gjyqtarëve; numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve; numri i çështjeve; pasiviteti i plotë i autoriteteve gjyqësore; mangësi sistematike në rregullat procedurale etj. Që nga nisja e deri në mbylljen e seancave, shkaqet që sjellin vonesa janë: dështimi për të thirrur palët ose dëshmitarët; hyrja me vonesë në fuqi e legjislacionit; mosmarrëveshje mbi kompetencën midis organeve administrative dhe gjyqësore; dërgimi me vonesa e dosjes gjyqësore; vonesa që u ngarkohet përfaqësuesve ligjorë; përfshirja e ekspertëve dëshmitarë; shtyrja e shpeshtë e seancave; hapësirë kohore e tepërt midis seancave, etj. Pas mbylljes së seancave, vonesat në çështjet civile rrjedhin nga: dështimi për të përdorur kompetencat nga gjykatat; mungesa ose pamjaftueshmëria e rregullave të procedurës civile etj. Pas mbylljes së seancave, vonesat në çështjet penale rrjedhin nga: problemet strukturore që lidhen me organizimin e shërbimit të prokurorisë; vendimet për t'u bashkuar ose jo me çështjet e tjera penale; dështimi i dëshmitarëve për të ndjekur seancat; roli i procedurave civile në rezultatin e procedimeve penale etj<sup>14</sup>.

Për momentin e fillimit dhe përfundimit të afatit të arsyeshëm për një çështje penale, ekzistojnë disa qëndrime. Lidhur me këtë, GJEDNJ ka nxjerrë vendime që kanë përcaktuar kritere të përgjithshme për

<sup>14</sup> Botim i OSBE, "Drejt drejtësisë: Analizë e çështjeve civile në gjykatat e rretheve gjyqësore", 2013, fq. 32-33



kohën e fillimit dhe përfundimit të afatit të arsyeshëm. Përmbajtja e vendimeve nuk është një standard i njëjtë, pasi natyra rasteve të trajtuara ndryshon nga njëri rast te rasti tjetër, por kjo nuk do të thotë se përfundimet arritura janë kundërthënëse mes vete. Në çështjen *Mc Farlane kundër Irlandës*, kjo gjykatë thekson që, në çështjet penale, nocioni “kohë e arsyeshme” e paraparë sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së, fillon të zbatohet sapo një person “të akuzohet”, ndërsa nocioni “akuzë”, mund të përkufizohet si “njoftimi zyrtar i dhënë një individit nga autoriteti kompetent për një pretendim se ai ka kryer një vepër penale”, një përkufizim që gjithashtu korrespondon me kriterin nëse “gjendja e tij (të dyshuarit) është prekur ndjeshëm”<sup>15</sup>. Ndërsa në çështjen *T. kundër Britanisë së Madhe*, kjo gjykatë thekson se nocioni “afat i arsyeshëm”, mbulon të gjithë procedurat penale, duke përfshirë edhe procedurat e apelimit dhe përcaktimin e dënimit<sup>16</sup>.

#### **4. E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor në jurisprudencën e Shqipërisë**

Sipas kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ, të reflektuara më pas në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që sjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjyqimit.

Garancia procedurale kushtetuese e gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm kohor parashikohet shprehimisht në nenin 42/2 të Kushtetutës shqiptare: “*Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*” si dhe në nenin 6 të KEDNJ: “*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm...*”

E drejta për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor është një nga disa garancitë që paraqet dispozita 6 e KEDNJ. Të gjykuarit në një kohëzgjatje të pajustificuar në raport me faktorët përbërës të

<sup>15</sup> *Mc Farlane v. Irlanda*, GJEDNJ, 2010, paragr. 143.

<sup>16</sup> *T. v. Britania e Madhe*, GJEDNJ, 1999, paragr. 108.

çështjes civile sjell pasiguri dhe humbje të interesit të palëve në gjykim për të pritur përfundimin e gjykimit dhe marrjen e një vendimi të formës së prerë. Të respektuarit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, vetvetiu të çon në pyetjen nëse do të kërkojmë drejtësi të bazuar në ligje apo do të tolerojmë të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe të pranojmë një tejzgjatje të afateve kohore duke “fituar” drejtësinë efektive? Periudhë e arsyeshme kohore nuk do të thotë “periudhë afatshkurtër” dhe se periudha e arsyeshme është tejkaluar apo jo, varet nga një ekzaminim i kujdesshëm dhe i plotë i të gjitha rrethanave të rastit, shkaqet e vonesave, etj<sup>17</sup>.

Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen artikullimin e saj edhe në dispozitat e K.Pr.C të Shqipërisë, sipas të cilave: “*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor...*”<sup>18</sup> dhe “*gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj*”<sup>19</sup>.

Në vendimin e saj nr. 35, datë 17.07.2013, GJK e Shqipërisë shprehet se lidhur me sjelljen e kërkueses, referuar kronologjisë së seancave, ajo nuk ka shkaktuar vonesa të pajustificuara për zhvillimin e gjykimit. Përkundrazi, prania e saj e vazhdueshme në të gjitha seancat tregon qartazi përpjekjet e saj për të shpejtuar procesin gjyqësor. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, rezultoi gjatë gjykimit, se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka filluar shqyrtimin e çështjes më datë 21.03.2011 dhe deri në momentin e paraqitjes së kërkesës në GJK, pas më shumë se dy vjetësh, ende nuk kishte një vendim themeli në lidhje me pretendimin e kërkueses. Kërkuësja pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është kujdesur që procesi të zhvillohet në mënyrë të rregullt duke siguruar progresin e gjykimit me shpejtësi të mjaftueshme, të reflektuara më pas në praktikën e GJK. Sipas saj, çështja e iniciuar nuk është një çështje komplekse, pasi faktet

<sup>17</sup> Patroni, P., “Durata irragionevole del processo e equa riparazione ai sensi della “legge Pinto” alla luce della recente giurisprudenza” Dirirtto&Diritti, 2007, ISSN 1127-8579.

<sup>18</sup> Neni 4 i Kodit të Procedurës Civile.

<sup>19</sup> Neni 171i Kodit të Procedurës Civile.

dhe natyra e çështjes janë përcaktuar që në fillim të gjykimit nëpërmjet parashtrimit të bërë dhe provave të paraqitura. Sipas kërkuesses, rrethanat e çështjes janë krejtësisht të qarta dhe nuk i japin rastit natyrë komplekse. Sa i përket sjelljes së autoriteteve publike, kërkuessa pretendon se zgjatja në kohë e kësaj çështjeje ka ardhur si rezultat i shtyrjes së seancave, pa shkaqe ligjore, nga ana e të paditurit dhe nga ana e gjykatës.

Sa i përket kompleksitetit, GJK konstatoi se gjykimi i iniciuar prej kërkuesses, i cili konkretisht kishte për objekt njohjen e saj si trashëgimtare ligjore të radhës së parë dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore, ishte i natyrës civile. Ky gjykim rregullohet prej dispozitave të K.Pr.C, mbi gjykimet civile dhe dispozitat e K.C, mbi padinë e kërimit të pasurisë trashëgimore (neni 349 e vijues). Gjykata konstatoi se, duke pasur parasysh natyrën e tij, gjykimi nuk paraqitej me natyrë komplekse edhe pse problemet juridike lidhur me juridiksionin dhe kompetencën, të pretenduara nga subjekti i interesuar, kishin kushtëzuar disa seanca. Megjithatë, ky fakt nuk justifikonte zgjatjen për më shumë se dy vjet të procesit.

Sa i përket sjelljes së autoriteteve publike, rezulton se nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë, deri në momentin e shqyrtimit të kërkesës në GJK, ishin zhvilluar 21 seanca. Hapësira kohore e seancave nga njëra-tjetra është relativisht e gjatë, mesatarisht 5-6 javë. Pra, një diferencë shumë e madhe kohore midis një seance nga tjetra. Gjykata vlerësoi se gjykimi i kësaj çështjeje ishte tejzgjatur për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe nga veprimet e të paditurit, i cili gjithashtu kishte ndikuar në zvarritjen e procesit gjyqësor.

GJK e Shqipërisë, në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se në bazë të neneve 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës së RSH-së, individit legjitimohet për të vënë në lëvizje GJK, me pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme. Gjykata ka pranuar se kërkesat e individëve për cenimin e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, mund të merren në shqyrtim pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të

gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm<sup>20</sup>. GJK e Shqipërisë thekson se lidhur me tejzgjatjen e procesit gjyqësor ajo mbështetet në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ, të reflektuara më pas dhe në praktikën e saj. Sipas këtyre kriterëve, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve si dhe rrezikun që sjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit<sup>21</sup>. Psh, GJK në vendimin e saj<sup>22</sup>, trajton pretendimin e kërkuarës për moshqyrtim të çështjes brenda një afati të arsyeshëm kohor me pretendimin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është kujdesur që procesi të zhvillohet në mënyrë të rregullt duke siguruar progresin e gjykimit me shpejtësi të mjaftueshme. Kërkuarja i mbështet pretendimet e saj në kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ, të reflektuara më pas në praktikën e GJK. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, rezultoi gjatë gjykimit, se pas më shumë se dy vjetësh dhe ende nuk kishte një vendim themeli në lidhje me pretendimin e kërkuarës. Pas vlerësimit të kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkuarës e cila nuk kishte shfaqur vonesa të pajustificueshme (përkundrazi ajo kishte qenë prezente në mënyrë të vazhdueshme) dhe sjelljes së autoriteteve, të cilat i kishin zhvilluar seancat gjyqësore me hapësirë kohore 5-6 javë, GJK e Shqipërisë arriti në përfundimin se kërkuarës i ishte cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

## CONCLUSION

There are no reliable statistics on the length of court proceedings in Albania. However, in the general public and professional opinion, there is a general impression that court proceedings without justified reason are too long. In Albania, the average length of civil proceedings is “more than three years”. In order to protect human rights and to avoid the negative consequences for Albania that may arise if a large number of citizens address the European Court of Human Rights, adequate measures should be taken to improve the efficiency of the judiciary, such as computerization of courts, training of judges for the use of computers and education of judicial staff, extension of alternative

<sup>20</sup> Vendim i GJK nr.35, datë 17.07.2013, pika 8 e vendimit.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Po aty.

dispute resolution through mediation, which should be a permanent task that needs to be worked towards increasing the modernization and efficiency of justice.

With regard to the length of proceedings, the ECtHR has established methods to calculate the length of proceedings. For startup, the calculation point is different in civil, criminal and administrative cases. In civil cases, it is normally the date on which the case is referred to the court; in criminal cases, the day of commencement may also be the date on which the suspect was arrested or charged or on which the preliminary investigations have started. In administrative issues, the calculation point is the date on which the first applicant refers the matter to the administrative authorities. The end of the period evaluated by the court is: in criminal cases, the date on which the final decision on the material file or the decision by the prosecution or the court to give up the case has been given. In civil cases, the deadline corresponds to the date on which the decision becomes final.

The question of what we are most interested in is a quick solution to the issue or a cost-effective solution, so we do not have to respond positively to one of the alternatives. It would be effective, the balance between 'time' factor and justice. In Albania, limited material resources, lack of space, and loads of cases in many cases obstruct the court system to address issues in a timely manner.

Concerning the conduct of a trial within a reasonable time, it was found that it differs from whether we are in a criminal or civil case, since in each case the complexity and nature of the case will be taken into account, the number of the participating parties, the number witnesses, linking the case to other issues, etc. During the study, we specified that the reasonable time frame in civil proceedings is related to the time when the procedure started, the time when the court issues the final decision and the time at which the decision is executed. While in criminal proceedings, delays in time are justified by the complexity of the case or the conduct of the parties.

The length of court proceedings should be monitored through an integral and well-defined system of information gathering. Such a system should be able to provide rapid statistical data for the length of proceedings at a general level, and to identify individual cases that have been excessive and unreasonable.

In time management of the process, special attention should be paid to the interests of the participants. They have the right to be

involved in planning the process at an early stage. Whenever possible, a judge should try to reach agreement with all participants regarding the procedural calendar. For this purpose, it should be assisted by the appropriate staff of the courts (employees) and the IT staff. In principle, the extension of time limits should only be possible with the consent of all parties, or if the interests of justice require so.

**Recensentë:**

**Prof. dr. Jeton Shasivari**

**Prof. dr. Afrim Osmani**

**BIBLIOGRAFIA**

**Libra, artikuj, dokumente juridike dhe vendime gjyqësore**

-Zendeli, E., “E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm”, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, 2009.

-Albers, P., “The experiences of the Netherlands” kumtesë në tryezën e rrumbullakët të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës me titull “The right to trial within a reasonable time and short-term reform of the European Court of Human Rights”, 2009.

-Omari, L; Anastasi, A., “E drejta Kushtetuese” Tiranë, 2008.

-Zsuzsanna Lőcsey-Illés, Eszter Tamási, Áron László Tóth “How to execute the "reasonable time" decisions of the ECHR—Reactions of the Hungarian legislation”, 2009.

-C.H. van Rhee., “In within a Reasonable Time: The History of due and undue delay in Civil Litigation”, 2010.

-European Commission For the Efficiency Of Justice (Cepej) Length of court proceedings in the member states of the Council of Europe based on the case law of the European Court of Human Rights, 2nd Edition, 2011.

-KE, “The Right to a Fair Trial” Collection Science and technique of democracy, No.28, 2010.

-KE, “Eradicating Impunity for Serious Human Rights Violations”, 2011.

-Botim i OSBE, “Drejt drejtësisë: Analizë e çështjeve civile në gjykatat e rretheve gjyqësore”, 2013.

-Patroni, P., "Durata irragionevole del processo e equa riparazione ai sensi della "legge Pinto" alla luce della recente giurisprudenza" *Diritto&Diritti*, 2007.

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

-Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.

-Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr.35, datë 17.07.2013.

-Mc Farlane v. Irlanda, GJEDNJ, 2010.

-T.v. Britania e Madhe, GJEDNJ, 1999.

-Scopelliti kundër Italisë, GJEDNJ, 1993.